



MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

RREGULLORE

Nr. 6772, date 21.07 2010

PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKËRENDUES TË MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

Rregullorja "Për funksionimin e Këshillit Bashkërendues të Mbrojtjes së Konsumatorëve" (me poshtë rregullorja) del në zbatim të Nenit 50, paragrafi 5 i Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve:

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Rregullorja përcakton funksionet dhe organizimin e veprimtarisë së Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve (me poshtë Këshilli).

Neni 2

Këshilli është organ konsultativ në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (me poshtë Ministria).

KREU II FUNKSIONET

Neni 3

1. Objekti i punës së Këshillit është nxitja e diskutimeve të përbashkëta, shkëmbimi i pikëpamjeve e opinioneve, midis përfaqësuesve të organeve të ndryshme shtetërore, me kompetenca në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse të konsumatorëve dhe shoqatave të biznesit, si dhe miratimi i deklaratave e rekomandimeve për çështjet që lidhen me politikën dhe masat organizative në mbrojtje të konsumatorit.
2. Këshilli funksionon në drejtim të:
 - a. koordinimit të përgatitjes së strategjive afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e politikave të mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut;

- b. përgatitjes se programeve te veprimeve për zbatimin e politikave te mbrojtjes se konsumatorëve;
- c. koordinimit te përgatitjes se projekt akteve normative për mbrojtjen e konsumatorëve;
- d. këshillimit te Ministrit te Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes për zbatimin e një politike qeveritare eficiente për mbrojtjen e konsumatorëve dhe integrimin e saj me politikat e tjera sektoriale;
- e. dhënies se opinioneve mbi projekt aktet normative me ndikim ne mbrojtjen e konsumatorëve;
- f. parashtrimin e propozimeve për amendime te dispozitave ligjore ekzistuese te mbrojtjes se konsumatorëve, nëpërmjet Ministrit te Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- g. paraqitjes se propozimeve, ne kushtet e koordinimit te punës se organeve administrative, ne lidhje me një zbatim efikas te legjislacionit te mbrojtjes se konsumatorit;
- h. dhënies se rekomandimeve për nënshkrimin e marrëveshjeve te bashkëpunimit midis organeve te ndryshme zbatuese ne fushën e mbrojtjes se konsumatorëve;
- i. ngritjes se grupeve te punës specifike;
- j. promovimit dhe inkurajimit te adoptimit te praktikave te drejta tregtare ne treg;
- k. inkurajimit te lidhjes se marrëveshjeve midis shoqatave te konsumatorëve dhe organizatave profesionale te tregtareve.

KREU III

ORGANIZIMI I VEPRIMTARISE SE KESHILLIT

Neni 4

1. Këshilli përbehet nga Kryetari, Nënkyetari dhe anëtarët e caktuar ne përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 82, date 3.7.2008 “Për përbërjen e Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve”.
2. Kryetar i Këshillit është Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Këshilli zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij, Nënkyetarin
4. Shërbimet organizative dhe teknike, ne lidhje me veprimtarinë e Këshillit mbulohen nga Sekretariatit Teknik ne Drejtorinë e Mbikëqyrjes se Tregut, ne Ministri.
5. Pjesëmarrja ne mbledhjet e Këshillit është pa pagesë.

Neni 5

1. Këshilli mbledhet si rregull, jo me pak se një herë ne 4 muaj.
2. Këshilli mund te thirret për mbledhje te jashtëzakonshme, ne rast se është e nevojshme, nga Kryetari, ose me kërkesën e shumicës se anëtarëve.

Neni 6

1. Kryetari i Këshillit:
 - a. përfaqëson Këshillin;
 - b. vendos për rendin e ditës te mbledhjeve te Këshillit;
 - c. planifikon, organizon mbledhjet e Këshillit;
 - d. thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit;

- e. nënshkruan procesverbalin e mbledhjes.
- 2. Ne rast mungese të Kryetarit, mbledhja drejtohet nga Nënkryetari ose nga një person i autorizuar nga Kryetari.
- 3. Kryetari i Këshillit mund të delegojë disa prej fuqive të tij organizative, për një periudhë kohe të caktuar, tek Nënkryetari ose tek një person i autorizuar prej tij.

Neni 7

- 1. Ministritë dhe organizatat e përmendura në Urdhrin e Kryeministrit nr. 82, datë 3.7.2008 "Për përbërjen e Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve" caktojnë përfaqësuesit e tyre në Këshill.
- 2. Kur një anëtar i Këshillit nuk merr pjesë në 3 mbledhje radhazi të Këshillit, pa ndonjë arsye të vlefshme, anëtari humbet cilësinë e tij si anëtar i Këshillit. Në këtë rast, ministri përkatës ose drejtuesi i organizatës, sipas pikës 1, caktojnë një përfaqësues tjetër në Këshill.

Neni 8

Sekretariati Teknik i Këshillit:

- a. merr të gjitha masat organizative për përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit;
- b. informon me shkrim të gjithë anëtarët e Këshillit për mbledhjet e ardhshme dhe u dërgon të gjitha dokumentet, materialet dhe propozimet në lidhje me rendin e ditës sipas afatit të përcaktuar në Nenin 9, pika 2;
- c. mban procesverbalin e mbledhjes;
- d. dërgon procesverbalin e mbledhjes së Këshillit tek anëtarët, brenda 5 ditëve nga mbajtja e mbledhjes;
- e. informon anëtarët e Këshillit për ditën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjeve të jashtëzakonshme;
- f. mban dokumentet e Këshillit.

Neni 9

- 1. Rendi i ditës i caktuar për mbledhjet e Këshillit dhe materialet përkatëse, u dërgohet anëtarëve jo më vonë se 8 dite pune përpara datës së mbledhjes.
- 2. Për rastet e parashikuara në nenin 5, pika 2, rendi i ditës dhe materialet përkatëse u dërgohen anëtarëve të Këshillit jo më vonë se një ditë përpara datës së mbledhjes.
- 3. Çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë çështje për tu përfshirë në rendin e ditës të mbledhjes. Propozimi për çështjet shtese, të cilat nuk janë përfshirë paraprakisht në rendin e ditës të caktuar për mbledhjet e zakonshme, behet nëpërmjet Sekretariatit Teknik, jo më vonë se 5 dite pune përpara datës së mbledhjes. Materialet për këto çështje paraqiten në të njëjtën kohë.
- 4. Për raste të veçanta, të justifikuara nga nevoja për ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme, pavarësisht kushteve të vendosura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, anëtarët e Këshillit mund të vendosin diskutimin e çështjeve:

- a) të cilat nuk janë në rendin e ditës ose,

- b) për te cilat anëtarët e Këshillit nuk kane qenë te informuar sipas pikave 1, 2 dhe 3.

Neni 10

Mbledhjet e Këshillit janë te vlefshme, nëse ndiqen nga me shumë se gjysma e anëtarëve te tij.

Neni 11

Anëtarët e Këshillit marrin pjese ne mbledhje personalisht.

Neni 12

1. Kryetari i Këshillit mund te ftoje, me iniciative te tij ose me kërkesë te gjysmës se anëtarëve te Këshillit, përfaqësues te ministrive, institucioneve te tjera shtetërore, te cilët nuk janë anëtarë te Këshillit, si dhe ekspertë te pavarur, ose ekspertë te fushës se mbrojtjes se konsumatorëve, apo persona te tjerë, ekspertiza e te cilëve mund te kontribuojë ne punën e Këshillit.
2. Këshilli mund te vendose për, ngritjen e grupeve dhe/ose komisione te veçanta pune për shqyrtimin dhe diskutimin e çështjeve specifike ne lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve.

Neni 13

1. Raportet, deklaratat, opinionet dhe rekomandimet e Këshillit, miratohen me shumicën e thjeshte te anëtarëve te tij.
2. Materialet e parashikuara në pikën 1 u dërgohen organeve përkatëse për marrjen e tyre në konsideratë.
3. Materialet e parashikuara në këtë nen, me miratimin e anëtarëve të Këshillit, publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Neni 14

1. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit në bashkëpunim me strukturat e tjera të lidhura me mbrojtjen e konsumatorit informon Këshillin për aktivitetet vjetore të zhvilluara në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.
2. Sekretariati teknik mbledh dokumentacionin, dhe ja paraqet Këshillit, në mbledhjen e parë të vitit pasardhës.

Neni 15

Kjo Rregullore hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTER
DRITAN PRIFTI

